

Mbështetur në nenin 28 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 9723/2007 për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ky dokument përbën:

AKTIN E
THEMELIMIT
DHE
STATUTIN
E

MUST Consulting - SH.P.K

KAPITULLI I

Data Themelimit, Emri, Forma, Selia, Kohëzgjatja

Neni 1. Data e themelimit dhe Emri

- 1.1 Shoqëria "MUST Consulting" (në vijim "Shoqëria") e ndjekur në mënyrë të pandashme nga shkurtimi "Shpk", i cili përfaqëson formën ligjore të saj si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, është themeluar në datën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- 1.2 Në të gjitha dokumentat, faturat njoftimet dhe botimet të lëshuara nga Shoqëria, pavarësisht nga mënyra e dergimit emri saj do të ndiqet ose do të shoqerohet nga:
- i. Fjalet "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar" ose "Sh.p.k";
 - ii. Numri identifikimit Personal Tatimor (NIPT) të saj;
 - iii. Adresa e regjistruar, dhe
 - iv. Pasqyrimin e faktit që shoqëria është në procedurë likuidimi, në qoftëse ky rast paraqitet.

Neni 2. Forma Ligjore e Shoqërisë

- 2.1 Shoqëria është një entitet Shqiptar, dhe ka formën ligjore të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar ("shoqëri me përgjegjësi të kufizuar"), në pajtim me Ligjin 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarë dhe Shoqëritë Tregtare" ("**Ligji**")

Neni 3. Selia Shoqërisë

- 3.1 Në momentin e miratimit të këtij Statuti, Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga "DERHEMI", Nd 7, H.7, Ap.10, Njesia administrative Nr.2, Tirane, Shqipëri. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë seline e saj në një adresë dhe/ose në një qytet tjetër të Shqipërisë. Shoqëria mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi kudo brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 4. Kohëzgjatja

- 4.1 Kohëzgjatja e Shoqërisë është për një periudhë të pacaktuar.

KAPITULLI II

Neni 5. Objekti Shoqerise

5.1 Ne momentin e miratimit te ketij Statuti, objekt i aktivitetit te Shoqerise eshte:

5.1.1 Objekti aktivitetit te Shoqerise do te jete aktiviteti ne fushen e dhenies se konsulences dhe trajnimit profesional si kurseve profesionale per individe dhe/ose kompani etj., mbi sherbimin e sigurise ushqimore e keshillimeve te standarteve nderkombetare ISO, auditime te jashtme te standarteve te ndryshme ISO, qe prekin fushat, por jo te limituara ne: sigurine ushqimore, sigurine teknike, te dhenat personale, paketat higjeno-sanitare, konsulencat e marketingut, shitjes, menaxhimit financiar dhe menaxhimin e biznesit. Konsulenca per kulinarine, sherbimin e menaxhimit te hoteleri – turizmit. Po ashtu, kompania keshillon, organizon apo zhvillon projekte BTL & ATL dhe PR ne fushen e marketingut, e cdo gje tjeter qe i perkete fushes se konsulences.

5.1.2 Objekti aktivitetit te Shoqerise mund te zhvillohet brenda dhe jashte Republikes se Shqiperise.

5.2 Pervec kesaj ne perputhje me legjislacionin Shqiptar, Shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet qe lidhet direkt ose indirekt, qe eshte rezultat ose lidhet me objektivin e mesiperme. Shoqeria gjithashtu mund te kryeje veprimtari si export - import te produkteve kulinare, apo aksesore/pajisje te nevojshme per fushat e konsulences, perpunimin e produkteve dhe nenprodukteve ushqimore dhe aksesore/pajisje te nevojshme, tregtimin e pijeve alkalke dhe joalkolike si dhe cdo veprimtari qe nuk ndalohet nga legjislacioni Shqiptar ne fuqi.

Neni 6. Ndryshime

6.1 Shoqeria ka te drejte te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj ne cdo kohe sic parashikohet ne kete Statut.

KAPITULLI III

Kapitali themeltar; Kuotat

Neni 7. Kapitali

7.1 Kapitali shoqerise eshte 100 leke i ndare ne 1 kuote me vlere nominale 100 leke, i cili do te dorezohet nga ortaku i shoqerise si me poshte vijon, Kapitali do te paguhet ne para.

Neni 8. Ortaket e Shoqerise dhe Kuotat

Pjesemarrja e ortakeve ne kapitalin e Shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre si me poshte:

1. Ortaku vetem themelues: Entela Vasil Koçiaj, shtetase Shqiptare, lindur me 17/06/1968 ne Tirane , Shqiperi, mbajtese e kartes se identitetit me numer G85617041C, nr kartes 028470591, zoteruese e 1 (nje) kuote me vlere nominale 100 (njqind) leke qe perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise;

Neni 9. Zmadhimi dhe zvogelimi kapitalit themelar

9.1 Kapitali mund te zmadhohet ose zvogelohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, sipas Kapitullit IV te ketij Statuti dhe kerkesave te detyrshme te Ligjit.

9.2 Zmadhimi kapitalit mund te realizohet me ane te kontributeve ne para ose me ane te kontributeve ne natyre, si dhe ne perfshirjen e rezervave (nese ka) ose te fitimit apo kthimit te borxhit ne kapital.

9.3 Zmadhimi kapitalit mund te behet duke emetuar kuota te reja apo duke rritur vleren nominale te kuotave ekzistuese.

Neni 10. Te drejtat dhe detyrimet e Ortakeve

10.1 Cdo kuote jep te drejten e nje vote ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve ("*Asambleja e Ortakeve*"), te drejten per te marre pjese ne shperndarjen e fitimeve te Shoqerise, kur deklarohet nga Ortaket e Shoqerise.

10.2 Ortaket do te kene akses te plote ne cdo informacion dhe te dhene qe ka lidhje me aktivitetin e Shoqerise ne cdo kohe, perfshire te drejten per te kontrolluar regjistrimet e Shoqerise dhe cdo dokument tjeter.

Neni 11. Transferimi Kuotave

- 11.1 Ortaket mund te transferojne lirisht kuotat e zoteruara prej tyre ne Shoqeri ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi.

KAPITULLI IV

Asambleja Pergjithshme

Neni 12. Kompetencat

- 12.1 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte organi kontrollues dhe vendimmarres i Shoqerise I cili merr vendimet mbi aktivitetin dhe politikat e saj ekonomike dhe tregtare.
- 12.2 Asambleja e Pergjithshem e ortakeve duhet te vendose ne lidhje me ceshtjet e meposhtme:
- i. Percaktimin e politikave tregare te shoqerise;
 - ii. Ndryshimin e statutit;
 - iii. Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
 - iv. Emerimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar;
 - v. Percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne piken (iii) dhe (iv);
 - vi. Mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire perгатitjen dhe miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - vii. Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
 - viii. Pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - ix. Perfaqesimin e Shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
 - x. Riorganizimin dhe prishjen/shitjen e Shoqerise;
 - xi. Miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te Asamblese;
 - xii. Ndryshimin e formes ligjore te Shoqerise;
 - xiii. Ndryshimin e emrit te Shoqerise;
 - xiv. Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statute.

Neni 13. Thirrja e Asamblese se Pergjithshme

- 13.1 Asamblesja e Pergjithshme duhe te mblidhet te pakten 1 (nje) here ne vit;
- 13.2 Asambleja e Pergjithshme mblidhet ne rastet e parashikuara nga Ligji Nr. 9901 date 14.4.2008 "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"
- 13.3 Asamblesja e Pergjithshme thirret nga administratori ose ortaket e shoqerise.

- 13.4 Thirrja e Asamblese se Pergjithshme do te behet permes nje njoftimi me shkrese ose permes postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje: (i) vendin; (ii) daten; (iii) oren e mbledhjes dhe (iv) rendin e dites e do t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vonë se 7 dite perpara dates se parashikuar per mledhjen e asamblese. Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur si me sipër, ajo mund te marre te vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullise.
- 13.5 Ortaket mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetër apo nga nje person i tretë. Administratoret nuk mund te veprojnë si perfaqesues te ortakeve ne asamblene e pergjithshme.
- 13.6 Cdo kuote perfaqeson nje vote.

Neni 14. Marrja e Vendimeve

- 14.1 Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 perqind te koutave. Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje te cilat kerkojne shumice te kualifikuar ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike sipas parashikimeve te pikes (3) te nenit 88 te Ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare". Asambleja e Pergjithshme vendos me $\frac{3}{4}$ e votave te ortakeve pjesmarres per: (a) ndryshimin e statutit; (b) zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, (c) shperndarjen e fitimeve; (d) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise. Per ceshtjet e tjera si:
- a) Percaktimin i politikave tregtare te shoqerise;
 - b) Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
 - c) Emerimin dhe shkarkimin likuiduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar;
 - d) Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - e) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet te tjera ndaj administratoreve;
 - f) Miratimin e rregullave procedural te mbledhjeve te asamblese.

Neni 15.

Administrimi

15.1 Ne momentin e miratimit te ketij Statuti dhe Aktit te themelimit, Administratori Shoqerise eshte: Znj. Entela Vasil Koçiaj shtetase Shqiptare, lindur me 17/06/1968, ne Tirane, Shqiperi, mbajtese e kartes se identitetit me numer 028470591.

15.2 Kohezgjatja e emerimit te Administratorit eshte per nje periudhe prej pese (5) vjetesh, duke filluar nga data regjistrimit te ketij Statuti prane Qendres Kombetare te Regjistrimit, me te drejte ripërteritje te ketij mandati.

15.3 Pas pranimit te emerimit te tij, Administratori njeh se marredhenia e tij me Shoqerine ndertohet mbi baza mirebesimi; ne kete drejtim vendimi per heqjen e tij me ane te vendimit te Asamblese se Pergjithshme gjykohet si arsye e ligjshme per shkarkimin e tij, bazuar ne ligjet perkatese ne fuqi.

15.4 **Kompetencat e Administratorit**

Administratori ka te drejatat dhe detyrimet si me poshte:

- a) Kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te Shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare te vendosura nga Asambleja Pergjithshme;
- b) Perfaqesoje Shoqerine;
- c) Mbaje ne menyre te sakte dhe te rregullt dokumentat dhe librat kontabel te Shoqerise;
- d) Pergatise dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarese;
- e) Krijoje nje system paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e Shoqerise;
- f) Kryeje regjistrimet dhe te dergoje te dhenat e detyrueshme te shoqerise sic parashikohet ne Ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;
- g) Raportoje perpara Asamblese se Pergjithshme ne lidhje me zbatimin e vecante per veprimtarine e Shoqerise;
- h) Kryeje detyrat e tjera te percaktuara ne ligj.

15.5 Administratori do te jete pergjegjes individualisht ndaj Shoqerise ose ndaj te treteve per shkelje te ligjeve, Statutit apo per faje te kryera gjate administrimit te Shoqerise. Pasojat e marreveshjeve te pa miratuara nga Asambleja Pergjithshme qe i sjellin dem Shoqerise I ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht, sipas rastit pasojat perkatese.

15.6 Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17, 18 te Ligjit per Shoqerite Tregtare, administratori detyrohet te:

- i. Te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne Statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te Shoqerise ne teresi, duke I kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis.;
 - ii. Te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne Statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;
 - iii. Te vleresoje me pergjegjesi ceshtjet per te cilat merret vendim;
 - iv. Te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, present apo te mundshem, te interesave personale me ata te Shoqerise;
 - v. Te ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshme.
- 15.7 Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, pergjigjen ndaj shoqerise per cdo veprim ose mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese kur veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.
- 15.8 Nese Administratori vepron ne kundersiztim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, si me siper, eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje cdo fitim personal te perfituar qe Administratori ose te personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave ne menyre te rregullt sipas standarteve te kerkuara.
- 15.9 Ne menyre te vecante, por pa u kufizuar ne to, administrator eshte i detyruar t'i demshperbleje Shoqerise demet e shkaktuara, nese, ne kundersiztim me dispozitat e ligjit per Shoqerite Tregtare, kryen veprimet e meposhtme:
- i. U kthen ortakeve kontributet;
 - ii. U paguan ortakeve interesa apo dividente;
 - iii. U shperndan aktivet e shoqerise;
 - iv. Lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare, kur, ne baze te gjendjes financiare duhej te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet;
 - v. Jep kredi

Neni 16. Administrimi Financiar

- 16.1 Asambleja Pergjithshme e Ortakeve cakton nje ekspert kontabel te autorizuar sipas legjislacionit Shqiptar.
- 16.2 Viti ekonomik financiar fillon ne ditën e pare te muajit Janar dhe perfundon ne ditën e 31 te muajit Dhjetor te secilit vit.

Neni 17 Mosmarreveshjet dhe ligji zbatueshem

- 17.1 Per mosmarrevesjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij Statuti si dhe per cdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.
- 17.2 Cdo ceshtje tjeter e cila nuk eshte permendur ne kete Statut, do te rregullohet nga dispozitat e Ligjit per Shoqerite Tregtare.

ORTAKU

Entela Kociaj

Entela Kociaj



Must Consulting Sh.p.k.

21/06/2019